

Informacion periodik mbi riskun Q1-2023 i konsoliduar

Tabela 4: Mjaftueshmëria e kapitalit

Informacion cilësor

Banka bën përlogaritjen e kapitalit regulator sipas kërkesave të rregullores "Për kapitalin rregullator të bankës", në fuqi nga data 30.06.2015

Informacion sasior

RREZIKU I KREDISË

Tabela më poshtë detajon zërat e ekspozimeve dhe ekspozimeve të ponderuara me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde, të përcaktuar respektivisht në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit". (Vlerat në Lekë)

040	1.	Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)	119,907,625,770.15
050	1.1	Klasat e ekspozimit sipas SA duke përfshirë pozicionet e titullimit	119,907,625,770.15
060	1.1.1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	4,562,718,929.93
070	1.1.2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	-
080	1.1.3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);	0.00
090	1.1.4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	-
100	1.1.5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	0.00
110	1.1.6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	8,803,143,053.72
120	1.1.7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	51,781,923,043.87

130	1.1.8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	36,648,813,885.43
140	1.1.9	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	3,654,029,784.03
150	1.1.10	Ekspozime (kredi) me probleme;	1,363,347,616.38
160	1.1.11	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	7,069,710,272.82
170	1.1.12	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	-
180	1.1.13	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	-
190	1.1.14	Zëra të tjerë	6,023,939,183.98
200	1.2	Pozicionet e titullzimit SA	-
200*	1.2*	<i>nga të cilat: rititullzime</i>	

RREZIQET E TREGUT

Tabela më poshtë përmbledh kërkesën për kapital për rrezikun e tregut, e llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” (Vlerat në lekë)

210	2.	Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	2,175,561,710.82
220	2.1	Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes	-
230	2.1.1	Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	-
240	2.1.2	Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	-
250	2.2	Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)	2,175,561,710.82
260	2.2.1	Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	-
270	2.2.2	Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	-
280	2.2.3	Rreziku i kursit të këmbimit	2,175,561,710.82
290	2.2.4	Rreziku i investimeve në mallra	-
300	2.3	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përqendrimit në librin e tregtueshëm	

RREZIKU OPERACIONAL

Tabela e mëposhtme detajon kërkesën për kapital për rrezikun operacional, e llogaritur sipas Metodës Standarde, të përcaktuara në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

310	3.	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	18,692,275,358.73
320	3.1	Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	
330	3.2	Metoda Standarde / Standarde Alternative	18,692,275,358.73

Tabelë 6: Rreziku i kredisë: Informacion i përgjithshëm

Fondet rezervë krijohen në momentin kur ekziston një evidencë objektive për humbjen.

Evidencë objektive që një aktiv financiar ose grup aktivesh është i zhvlerësuar përfshin të dhënat e mbikëqyrura, në bazë të ngjarjeve të mëposhtme:

- a) Vështirësi financiare të huamarrësit,
- b) Shkelje të kontratës,
- c) Falimentimi ose riorganizime të tjera financiare,
- d) Ndryshime negative në statusin e pagesave të huamarrësit,
- e) Mashtrime nga ana e klientit .

Provizionet sipas standardeve të Bankës së Shqipërisë përlllogariten në përputhje të plotë me standardet e përcaktuara në rregulloren “Për Administrimin E Rrezikut Të Kredisë Nga Bankat Dhe Degët E Bankave Të Huaja”

Bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar IFRS 9, RBAL kalkulon tre tipe të provigjoneve bazuar në ndryshimin e cilësisë së kredisë që nga njohja fillestare:

- **Faza 1** përfshin kreditë që nuk kanë pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare. Humbjet e pritshme 12-mujore janë humbjet e pritura të kreditit që rezultojnë nga ngjarjet e papaguara që pritet të ndodhin brenda 12 muajve pas datës së raportimit. Kjo është humbja e tërë e kredisë e ponderuar nga probabiliteti që humbja do të ndodhë në 12 muajt e ardhshëm. Humbjet e pritshme të vlerësuara për tre skenar makroekonomik janë ponderuar humbjet mesatare të kredisë me probabilitetin e shfaqjes së skenarit përkatës.
- **Faza 2** përfshin kreditë që kanë pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë që nga njohja fillestare, por që nuk kanë evidencë objektive të zhvlerësimit. Për këto asete, fondi rezervë njihet në jetëgjatësi. Kjo është humbja e tërë e kredisë e ponderuar nga probabiliteti që humbja do të ndodhë deri në jetëgjatësi e kredisë. Humbjet e pritshme të vlerësuara për tre skenar makroekonomik janë ponderuar humbjet mesatare të kredisë me probabilitetin e shfaqjes së skenarit përkatës.

- **Faza 3** përfshin kreditë që kanë dëshmi objektive të humbjes në datën e raportimit. Fondi rezervë për kreditë është i barabartë me prodhimin e ekspozimit të kredisë me përqindjen e humbjes (si rezultat i metodave të brendshme statistikore).

Klientët individë dhe Micro të cilët punojnë ose operojnë në industrinë më të prekura nga COVID, janë klasifikuar në Fazën 2 pavarësisht se kredia e tyre nuk ka shfaqur shenjat në rritjen e riskut të kredisë. Duke filluar nga Shtatori 2020, klientët që kanë treguar performancë të mirë me pagesën në kohë të kredisë gjatë kësaj periudhe dhe bazuar në faktin që operojnë në industrinë që nuk konsiderohen me risk të lartë, janë klasifikuar në Fazën 1.

Tabelë 7: Rreziku i kredisë : Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standard

Në tabelën më poshtë mund të gjeni një informacion përmbledhës për secilën klasë të ekspozimit sipas klasifikimit në rregulloren “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit” që përfshin:

- emrat e Institucioneve të jashtëm të vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe Agjencive të kreditimit të eksporteve (ECA);
- klasat e ekspozimit për të cilën është përdorur Institucioni i jashtëm i vlerësimit të kredisë (ECAI) dhe Agjencia e kreditimit të eksporteve (ECA)

a)	KLASAT E EKSPOZIMIT	EMËRTIMI I KLASAVE TË EKSPOZIMIT	EMRI I INSTITUCIONIT TË JASHTËM TË VLERËSIMIT (ECAI)
a		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
b		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
c		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
d		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
e		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	-
f		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
g		Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS

h	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
i	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	-
j	Ekspozime (kredi) me probleme;	-
k	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	-
l	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	FITCH, MOODY'S, STANDARD & POORS
m	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	
o	Zëra të tjerë	-

Tabela më poshtë detajon Vlerat e ekspozimeve sipas cilësisë së kredisë para dhe pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë, si dhe vlerat e ekspozimeve të zbritshme nga kapitalit rregullator, sipas klasave të ekspozimit në bazë të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.

Njësia monetare: ALL				
KLASAT E EKSPOZIMIT	EMËRTIMI I KLASAVE TË EKSPOZIMIT	EKSPOZIMI PARA APLIKIMIT TË TEKNIKAVE TË ZBUTJES	EKSPOZIMI PAS APLIKIMIT TË TEKNIKAVE TË ZBUTJES	
a	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore;	112,754,815,864.90	118,689,191,083.42	
b	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale;	-	-	
c	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe ndërmarrjeve jo tregtare (organizatat joqeveritare/jofitimprurëse);	-	-	
d	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit;			
e	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare;	7,825,163,338.51	7,825,163,338.51	

f	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura;	37,400,919,678.05	37,400,919,678.05
g	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave);	78,102,560,823.15	71,503,667,501.11
h	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail);	54,930,663,696.89	54,311,537,112.89
i	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme;	8,296,453,120.86	8,296,453,120.86
j	Ekspozime (kredi) me probleme;	1,475,642,692.88	1,385,849,381.70
k	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë;	6,173,595,012.38	6,173,595,012.38
l	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara;	0	0
m	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK;	0	0
o	Zëra të tjerë	14,149,296,739.79	14,149,296,739.79
	Ekspozime te zbritshme nga kapitali rregullator	2,328,565,130.00	2,328,565,130.00

Tabelë 8: Teknikat e zbutjes së rrezikut

Me qëllim zbutjen e rrezikut të kredisë, Banka Raiffeisen përdor disa lloje kolateralesh të cilat po i detajojmë më poshtë:

Mbrojtje e financiar e Kredisë	Kolateral Financiar	Cash
		Letra me vlerë
	Prona të patundshme	Prona të Patundshme Komeriale (CRE)
		Prona të Patundshme Rezidenciale (RRE)
Llogari të arkëtueshme	Kalim i të drejtave të të gjitha llogarive të arkëtueshme	

		Kalim i të drejtave të llogarive të arkëtueshme nga një kontratë specifike
	Kolaterale të tjera fizike	Peng mbi kuotat e biznesit
		Peng mbi makineri
		Peng mbi Inventar
		Peng mbi llogari të arkëtueshme
		Peng mbi pasuri të luajtshme
		Peng në makina
Sigurim Jete		
Mbrojtje e Pafinancuar e Kredisë	Garanci	Garanci Shtetërore
		Garanci Bankare
		Garanci Korporatore

Banka ka disa procedura të brendshme të cilat rregullojnë vlerësimin dhe administrimin e kolateraleve. Këto politika kanë bazën në parimet e mëposhtme:

1. Prona duhet të ketë një titull ligjor të vlefshëm

Titulli ligjor i kolateralit duhet të jetë i dokumentuar shumë mirë dhe banka sigurohet që inskripti mbi pronën në fjalë të jetë ligjërishit i imponueshëm sipas kuadrit ligjor të Republikës së Shqipërisë.

2. Vlerë e qendrueshme

Kolaterali duhet të ofrojë vlerë të qendrueshme të paktën për afatin maksimal të kontratës së kredisë. Ky kusht monitorohet dhe vlerësohet rregullisht. Në rast të rënies së vlerave, banka merr masa të menjëherëshme për përmirësimin e situatës.

3. Vlerë e kthyeshme ne cash

Kolaterali duhet të ketë një vlerë e cila mund të kthehet në cash në një kohë të arsyeshme, kjo e provuar nga eksperiencia në Republikën e Shqipërisë. Nëse likuidimi i pronës është i dyshueshëm atëherë kolaterali vlerësohet me vlerë 0.

4. Pak ose aspak korrelacion

Korrelacioni i gjendjes financiare të klientit me kolateralin e marrë për kredinë duhet të jetë shumë i pakët. Sa më i lartë të jetë korrelacioni midis të dyjave aq më e ulët është vlera e kolateralit. Një shembull i korrelacionit të madh është përdorimi i një Letre me Vlerë e lëshuar nga Kompania X si kolateral për një kredi që i jepet kësaj kompanie.

Llojet kryesore të ofruesve të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë janë si më poshtë:

- Qeveritë qendore dhe bankat qendrore;
- Qeveritë lokale;
- Bankat multilaterale të zhvillimit:
 - the International Bank for Reconstruction and Development
 - the International Finance Corporation
 - the Inter-American Development Bank
 - the Asian Development Bank
 - the African Development Bank
 - the Council of Europe Development Bank
 - the Nordic Investment Bank
 - the Caribbean Development Bank
 - the European Bank for Reconstruction and Development
 - the European Investment Bank
 - the European Investment Fund
 - the Multilateral Investment Guarantee Agency
 - the International Finance Facility for Immunization
 - the Islamic Development Bank
 - the Inter-American Investment Corporation
 - the Black Sea Trade and Development Bank
 - the Central American Bank for Economic Integration
 - the CAF-Development Bank for Latin America
- Organizatat Ndërkombëtare:
 - Komuniteti Evropian
 - Fondi Monetar Ndërkombëtar
 - the Bank for International Settlement
 - the European Financial Stability Facility
 - the European Stability Mechanism
- Njësitë e sektorit publik.
- Banka dhe institucione financiare të vlerësuara me një gjendje të mirë financiare

- Korporatë dhe kompani të tjera të cilat janë analizuar nga Banka Raiffeisen dhe janë vlerësuar në gjendje të mirë financiare

LLOJI I MBROJTJES SË FINACUAR	EKSPozIMI NË RASTIN E PËRDORIMIT TË MBROJTJES SË FINACUAR
Kolateral financiar	1,373,437,998.71
Netimi në bilanc	-
Marrëveshjet tip të netimit/kompensimit	-
Mbrojtje të tjera të pranueshme	-
LLOJI I MBROJTJES SË PAFINANCUAR	EKSPozIMI NË RASTIN E PËRDORIMIT TË MBROJTJES SË PAFINANCUAR
Garanci	5,934,375,218.52
Kundërgaranci	-
Derivatvët e kredisë	-

Tabelë 9: Rreziku i kredisë së kundërpatisë (çdo tremujor)

N/A

Tabelë 10: Titullzimi (çdo tremujor)

N/A

Tabela 11: Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm

Informacion Cilësor:

Mjaftueshmëria e kapitalit për rrezikun e tregut është llogaritur në bazë të Kapitulli VII të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit”, pasi kushtet e mëposhtme plotësohen për fundit e muajit Dhjetor 2022:

- gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, raporti i vlerës mesatare kontabël të librit të tregtueshëm ndaj totalit të aktivit nuk është më i lartë se 5%. Në asnjë kohë ky raport nuk është më i lartë se 6%;
- gjatë dy gjashtëmujorëve të fundit, vlera mesatare kontabël e librit të tregtueshëm nuk është më e lartë se 15 milionë euro. Në asnjë kohë kjo vlerë nuk është më e lartë se 20 milionë euro.

Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut është llogaritur si shuma e rrezikut të Pozicionit (Rreziku i Përgjithshëm dhe Rreziku Specifik), rrezikut të Përqendrimit në librin e tregtueshëm, Rreziku i Shlyerjes dhe rrezikut të Kursit të Këmbimit. Llogaritjet janë bazuar në metodën standarde.

- Rreziku i Pozicionit për titujt e borxhit
 - Rreziku i Përgjithshëm për titujt e borxhit është përlllogaritur duke u bazuar në Metodën e Maturitetit të titujve.
 - Rreziku Specifik për titujt e borxhit bazuar në Shkallën e Cilësisë së Kredisë. Rreziku Specifik për librin e tregtueshëm për fundin e muajit është 0, pasi libri i tregtueshëm përbëhet vetëm nga tituj borxhi të Qeverisë Shqiptare, të cilat kanë Shkallën e Cilësisë së Kredisë 1 (RW është 0%).
- Rreziku i Përqendrimit në Librin e Tregtueshëm
Rreziku i Përqendrimit në librin e tregtueshëm për fund muajin është 0, pasi pozicionet e rrezikut në librin e tregtueshëm të bankës nuk e tejkalojnë kufirin maksimal të lejuar për ekspozimet e mëdha, të përcaktuara në “Rregulloren për Menaxhimin e Ekspozimeve të mëdha të bankave” (libri i tregtueshëm i bankës përbëhet tërësisht nga tituj të borxhit të Qeverisë Shqiptare.)
- Rreziku i Shlyerjes për shlyerjet e tipit Dorëzim Kundrejt Pagesës (Delivery vs Payment) ose anasjelltas. Rreziku i shlyerjes për transaksionet DVP është 0 për portofolin e fund muajit .
- Rreziku i kursit të këmbimit, përlllogaritet në rastin kur pozicioni total neto i hapur valutor është më e lartë se 2% të kapitalit rregullator. Për fundin e muajit, pozicioni total neto i hapur valuator është më i madh se 2% të kapitalit rregullator dhe ne kemi përlllogaritur kërkesë për kapital për këtë pozicion.

Informacion Sasior (mijë LEK):

	Ekspozimeve të ponderuara me rrezik	Kërkesa për Kapital
Shuma për rreziqet e tregut	2,175,561.7	174,044.9
Shuma e rrezikut të shlyerjes	-	-
Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	-	-
Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	-	-
Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)	2,175,561.7	174,044.9
Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	-	-
Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit		
Rreziku i kursit të këmbimit	2,175,561.7	174,044.9
Rreziku i investimeve në mallra	-	-

Tabela 12: Rreziku Operacional

Informacion Cilësor
<p>(a)</p> <p>Banka Raiffeisen përdor Metodën Standarde për përllogaritjen e kërkesave për kapital dhe Aktiveve të ponderuara me Risk për Rrezikun Operacional. Sipas kësaj metode, të ardhurat bruto (mesatarja e tre viteve të fundit) të Bankës Raiffeisen dhe Raiffeisen Leasing Sha. të siguruara nga sistemi SRU , ndahen në tetë linja biznesi me risk operacional (sipas përcaktimeve të rregullores së Bankës së Shqipërisë, Neni 185 tabela 30). Pastaj secila ndarje e të ardhurave bruto shumëzohet me faktorin beta që i korrespondon linjës së biznesit (β janë faktorë të përcaktuar). Më pas, rezultati total - $\sum GIn \& \beta_n$ – përcakton kërkesën për kapital për rrezikun operacional.</p> <p>Aktivitet e ponderuara me risk përllogariten duke shumëzuar kërkesën për kapital me një koeficient prej 12.5</p> <p>Përllogaritja e rrezikut operacional bëhet me baza vjetore, ndërsa raportimi bëhet me baza tremujore. Pra këtu paraqitet rreziku operacional llogaritur mbi bazën e të dhënave SRU lokale për muajin Dhjetor 2022.</p>
<p>(b)</p> <p>Kërkesa për kapital (EC) = 1,495,382,028.7</p>